

VENDIM
Nr.216, datë 10.4.2004

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
METROLOGJISË DHE TË KALIBRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.8996, datë 30.1.2003 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, e specializuar për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse.

2. Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit është:

- të ngrejë dhe të menaxhojë sistemin kombëtar të metrologjisë në Republikën e Shqipërisë, në pajtueshmëri me metrologjinë globale dhe rajonale;

- të mbrojë interesat e konsumatorëve, nëpërmjet organizimit të kontrollit të mjeteve matëse në sektorët e shëndetësisë, të higjienës, të sigurimit teknik dhe të shërbimeve;

- t'u ofrojë mundësi prodhuesve dhe përdoruesve që të sigurojnë saktësinë e mjeteve matëse, për të qenë konkurrues me prodhimet e tyre në tregun global.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit organizohet dhe funksionon sipas kësaj strukture:

- zyra qendrore, me seli në Tiranë;

- degë në çdo qark;

- zyra në çdo rreth.

4. Degët në qarqe janë në varësi të drejtorit të përgjithshëm, ndërsa zyrat në rrethe janë në varësi të degëve në qarqe.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri.

Për nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit, drejtuesit, shefat e sektorëve, specialistët dhe inspektorët e kontrollit të mjeteve matëse zbatohet legjislacioni për shërbimin civil, ndërsa për personelin mbështetës zbatohet legjislacioni i punës.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, për kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të veta, ngre dhe administron laboratorë të ruajtjes së etaloneve kombëtare në njësitë e matjes dhe të kalibrimit të mjeteve matëse. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit administrojnë laboratorët e tyre të kalibrimit dhe të verifikimit të mjeteve matëse, sipas rregullave administrative dhe teknike të përcaktuara.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, në bashkëpunim me institucionet e pushtetit qendror dhe vendor, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2004, të sigurojë mjediset e punës për strukturat në qendër dhe në rrethe, në përputhje me nevojat për rritjen e frytshmërisë në punë dhe realizimin e investimeve për përmirësimin e teknologjisë.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, përcakton emërtesën dhe nivelin e etaloneve kombëtare të njësive të matjes dhe rregullat për ruajtjen dhe përdorimin e tyre.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit mund të angazhojë edhe specialistë të jashtëm, të kualifikuar për kryerjen e detyrave të veçanta. Shpërblimi për këta specialistë të jetë 2500 lekë për ditë-punë, por jo më shumë se për një periudhë prej 30 ditësh në vit për çdo specialist.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në formën e subvencioneve ose granteve, nga të ardhurat që krijon nëpërmjet shërbimeve që kryhen dhe nga donacionet. Llogaritja dhe përdorimi i financimit nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e veta bëhen sipas rregullave të përcaktuara me akt të përbashkët të Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Financave.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit harton rregulloren e vet, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë. Në rregullore përcaktohen të drejtat dhe detyrat e çdo hallke të strukturës së kësaj drejtorie dhe të çdo punonjësi në veçanti, si dhe marrëdhëniet e veçanta të punës, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Drejtori i Përgjithshëm raporton, periodikisht, te Ministri i Ekonomisë për ecurinë e punës. Marrëdhëniet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe të Kalibrimit dhe strukturave përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë rregullohen në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Ekonomisë.

Ministri i Ekonomisë miraton strategjitë afatgjata të zhvillimit dhe planin vjetor të punës së kësaj drejtorie.

13. Vendimi nr.212, datë 4.5.1993 i Këshillit të Ministrave "Për metrologjinë", shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano